

TË BASHKUAR PËR DREJTËSI



Michigan • Verë 2011

Duke u përgatitur për fitore në vitin 2012

Kontratat më të mëdha të SEIU Local 1 skadojnë në vitin 2012... Në të gjitha shtetet e Local 1

KONTRATA JONË SKADON më 31 korrik. Është koha të ngremë standardet në kontratën tonë dhe të mbrojmë fitoret që kemi arritur. Së bashku, ne mund të fitojmë rrogat dhe përfitimet që na nevojiten për të mbajtur familjet tona.

Ti zotëron fuqinë që ta bësh sindikatën tonë më të fortë. Nëse çdo anëtar përkushtohet që të angazhohet dhe të mos e mbyllë gojën, ne do të arrijmë të hyjmë në vitin 2012 me një themel të fortë.

Në vitin 2010 arritëm të ruajmë kujdesin shëndetësor, rrogat dhe orët e punës, dhe tani do të bëjmë gjithçka që të fitojmë sërish në vitin 2012. •

MITING NË 28 SHTATOR

Kemi nevojë për pjesëmarrjen tënde! Detajet do të jepen së shpejti.

Të qëndrojmë së bashku dhe të lidhur.

- Regjistrohu në listën tonë me email: **SEIU1.ORG**
- Na gjej në Facebook: **Facebook.com/SEIULocal1**

Próximos eventos del Local 1

- Mitingu "We are the People"
Të premten, 26 gusht, ora 10:00 -11:00
614 S. Mail Street Plymouth, MI
- Parada e Ditës së Punëtorëve
Të hënë 5 shtator, 2011
Anëtarët e Local 1 do të takohen te Ndërtesa e Kujdesit Shëndetësor në Miçigan (Healthcare of Michigan Building) - 2604 4th St., Detroit - në orën 08:00.
- Mbledhja e Zakonshme e Anëtarësisë së SEIU Local 1
Të shtunën, 10 shtator, ora 10:00-12:00
Union Hall - 2211 E Jefferson, kati I

SEIU Local 1 organizon Piknikun e 5-të të Panairit Vjetor të Shëndetit

PIKNIKU I KËTIJ VITI, i organizuar të shtunën, 14 korrik në Belle Isle në Detroit, ishte sukses i jashtëzakonshëm. Me qindra anëtarë iu bashkuan festimeve me familjet e tyre dhe e kaluan pasditen duke shijuar së bashku një ditë të bukur vere. SEIU Local 1 falënderon të gjithë vullnetarët e përkushtuar dhe shitësit për ndihmën e tyre. •

Sindikata në veprim

Vetëm gjatë muajit korrik arritëm të grumbullojmë më shumë se \$4,200 në rroga të prapambetura për anëtarët.

NË 21 KORRIK, tre punonjës të cilët ishin anëtarë të SEIU Local 1 nga Metro Detroit, u pushuan nga puna pa të drejtë. Duke bashkëpunuar me SEIU, të tre punonjësit u rikthyen në vendet e tyre të punës në 29 korrik me pagesë të plotë për kohën e largimit, në kategorinë që kishin më parë, si dhe nga dosjet e tyre u hoq masa disiplinore.

NË SHKURT 2011, një punonjës i Omni i cili ishte anëtar i SEIU Local 1 u pushua nga puna pa të drejtë. Pasi kontaktoi me SEIU, anëtari u rikthye në vendin e punës në qershor; ai mori rrogat e prapambetura dhe masa disiplinore iu hoq nga dosja.

Local 1 ratifikoi me sukses kontratat e mëposhtme gjatë vitit 2011, duke fituar rritje rrogash dhe duke mbrojtur përfitimet:

- Kellogg (Omni) – Pastruesit e Grand Rapids
- Universiteti i Concordia-s (Aramark) – Punëtorët e shërbimit të kateringut të Ann Arbor
- GM Lansing (Drayton Group) – Pastruesit e Lansing
- Nederlander (Fisher) Në pritje – Pastruesit e Detroitit

60 punëtorë bashkohen me Local 1

SEIU LOCAL 1 vazhdon punën e madhe për zgjerimin e radhëve tona në Miçiganin perëndimor. Në 21 qershor, pastruesit në fabrikën e Kellogg's në Grand Rapids votuan për të ratifikuar kontratën e tyre të parë kolektive me marrëveshje, duke sjellë mbi 60 anëtarë të rinj të SEIU në Local 1 në Miçigan. Punëtorët fituan rritje rrogash, ditë pushimi në rast sëmundjeje, pagesë për pushime si dhe një ndihmë financiare për këpucë. Ne e përgëzojmë Komitetin Negociator të Kellogg's dhe Drejtoreshën Shtetërore Erica Kimble për punën e mirë. **Mirë se vini, anëtarë të rinj!** •

Je transferuar?

A E KA SEIU LOCAL 1 adresën tënde aktuale të postës? Nëse jo, kontakto SOT me Qendrën e Burimeve të Anëtarëve në numrin 877-233-8880 për të marrë informacion të rëndësishëm mbi sindikatën. •



"Më pëlqen që jam pjesë e sindikatës. E di që nëse kam ndonjë problem në punë, apo nëse më trajtojnë në mënyrë të padrejtë, kam dikë që më mbështet – dikë me kë të flas që m'i rregullon problemet në punë."

Chris Sherman Burns
Anëtar i Local 1 dhe kamerier suite në Joe Lewis Arena